



tirana  
EUROPEAN  
YOUTH  
CAPITAL 2022



BASHKIA  
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 35, datë 06.04.2022

“PËR

“MIRATIMIN E PLANIT TË INTEGRITETIT TË BASHKISË SË TIRANËS, 2022-2025”

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9 pika 1, nënpika 1.1, shkronja “a”, pikës 1, të nenit 28, gërmës “a”, të pikës 2, të nenit 33, të gërmës “k”, të nenit 54, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, të ligjit Nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të ndryshuar, të ligjit nr. 8778/2001 “Për Ratifikimin e Konventës Penale për Korrupsionin”, të ndryshuar, të ligjit Nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë, të ndryshuar, të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave”, të ndryshuar, të ligjit nr. 60/2016, “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 për “Menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 për “Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të nryshuar, të ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, të vendimit nr. 247, datë 20.03.2015, të Këshillit të Ministrave, për “Miratimin e Strategjisë Ndërsëktoriale kundër Korrupsionit për periudhën 2015-2023”, të ndryshuar, të Marrëveshjes së Bashkëpunimit nr.prot. 24942/3, datë 17.09.2021, të lidhur ndërmjet Bashkisë së Tiranës dhe Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim për “Zhvillimin e Planit të Integritetit për Bashkinë Tiranë në kuadër të Projektit “Zgjerimi i praktikës standarte të planifikimit të integritetit në nivel vendor”, si dhe në vijim të memos nr. prot. 3175/1, datë 21.01.2022, të Grupit të Punës, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I

1. Miratimin e Planit të Integritetit në Bashkinë e Tiranës 2022-2025, sipas materialit të përgatitur nga Grupi i Punës, ngritur me urdhrin nr.prot. 24942/4, datë 17.09.2021, të ndryshuar, të Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, bashkëlidhur këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Personi përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të planit të integritetit është Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Burimeve Njerëzore, i cili ka për detyrë të monitorojë zbatimin e Planit të Integritetit, veçanërisht planin e veprimit për menaxhimin e riskut të integritetit të Bashkisë së Tiranës, për veprime që mund të ndodhin dhe mund të çojnë në cënimin e integritetit të Institucionit.
3. Punonjësit e Bashkisë së Tiranës, me kërkesë të personit përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të planit të integritetit, duhet të dorëzojnë të dhëna dhe informata të një rëndësie të nevojshme për zbatimin e tij, të cilat nuk janë në kundërshtim me rregulloren e brendshme të institucionit në fuqi.

4. Në fund të vitit kalendarik, personi përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të planit të integritetit duhet të paraqesë para Këshillit Bashkiak një raport mbi zbatimin e planit të integritetit.

5. Ngarkohet e gjithë struktura organizative në Bashkinë e Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar.

**Z V / K R Y E T A R**

**VJOLLCA BRAHO**

